



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

---

Numri i lëndës: 2023:069054

Datë: 16.04.2024

Numri i dokumentit: 05576973

**C.nr.342/2023**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**, Departamenti i përgjithshëm, Divizioni civil, me gjyqtarin Fuad Haliti, në kontestin e paditësit Arben Boshnjaku nga Mitrovica të cilin sipas autorizimit e përfaqëson av.Besart Kadriu nga Mitrovica, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit av.Arbnor Murturi nga Prishtina, për shkak të pagesave të pagave mujore të papaguara, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datën 15.04.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Arben Boshnjaku.
- II. OBLIGOHET** e paditura – Komuna e Mitrovicës, që paditësit Arben Boshnjaku t'i paguaj shumën e përgjithshme në lartësi prej 6,147.92€ në emër të të ardhurave personale – pagave të papaguara për periudhën 01.11.2021 deri me 31.10.2022, dhe atë:
- Në emër të të ardhurave personale – pagave të papaguara shumën prej 4,576.32€ për periudhën 01.10.2021 deri më 31.12.2021 dhe kamatën prej 8% në shumën prej 840.44€;
  - Në emër të trustit pensional 5 % shumën në lartësi prej 505.44€ (252.72€ kontributi pensional i punëmarrësit dhe 252.72€ kontributi pensional i punëdhënësit), shumë të cilën obligohet e paditura që ta transferoj nga llogaria e punëdhënësit në të mirë të llogarisë së trustit pensional të paditësit(TRUSTI);
  - Në emër të tatimit në të ardhura personale shumën prej 225.72€, shumë të cilën obligohet e paditura që ta transferoj nga llogaria e punëdhënësit në Agjensionin Tatimor të Kosovës (ATK);
  - Të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.
- III. OBLIGOHET** e paditura – Komuna e Mitrovicës që në emër të shpenzimeve procedurale t'i paguaj paditësit shumën prej 534.00€, në afat prej 7 ditësh nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

## Arsyetim

### 1. *Pretendimet e palëve ndërgjyqëse*

Paditësi me datën 22.02.2023 pranë kësaj gjykate ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës me të cilën ka kërkuar që paditësit t'ia paguaj në emër të pagave të papaguara në shumën e përgjithshme prej 6,147.92€ për periudhën 01.11.2021 deri me 31.10.2022, me kamatë ligjore prej 8 %, duke filluar nga dita e parashtrimit të kësaj padie e deri në pagesën përfundimtare e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga marrja e këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur i autorizuari i paditësit deklaroi se mbes pranë precizimit të kërkesëpadisë të bërë në këtë seancë. Pas administrimit të provave u vërtetua qartë baza e kërkesëpadisë andaj i propozoi gjykatës që ta aprovoj kërkesëpadinë e paditësit, po ashtu i kërkoi shpenzimet e procedurës dhe atë për padi shumën prej 104 euro, për 2 seanca 270 euro, për pagesën e ekspertizës shumën prej 100 euro si dhe për taksë gjyqësore shumën prej 60 euro.

I autorizuari i të paditurës deklaroi se mbes në tërësi pranë deklaramëve të parashtruara në këtë seancë i propozoi gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar për shkak të mungesës së bazës ligjore, shpenzimet e procedurës i kërkoi në shumë prej 270 euro për dy seanca të mbajtura.

### 2. *Provat e administruara në shqyrtimin kryesor*

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat si në vijim: kontrata me nr.344/21 e datës 02.11.2021, kontrata me nr.169/22 e datës 17.10.2022, vërtetimi me nr.81/23 i datës 16.01.2023, kërkesa e datës 17.01.2023 dhe ekspertiza financiare e datës 01.03.2024 e ekspertes Ednora Kastrati.

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku duke gjetur se kërkesëpadija e paditësit është e **bazuar**.

### 3. *Faktet*

Me leximin e kontratës nr.344/21 e datës 02.11.2021, gjykata vërtetoi faktin se paditësit ka qenë i punësuar tek e paditura si mësimdhënës për periudhën kohore nga data 01.11.2021 me status të përkohshëm.

Me leximin e kontratës nr.169/22 e datës 17.10.2022, gjykata vërtetoi faktin se paditësit ka qenë i punësuar tek e paditura si mësimdhënës për periudhën kohore nga data 17.10.202 me kohë të pacaktuar.

Me leximin e vërtetimit me nr.81/23 i datës 16.01.2023, të lëshuar nga SHFMU “GJ.K.Skëndërbeu”, gjykata vërtetoi faktin se paditësit nuk ka marrë pagë një vit dhe se pagën e ka pasur në lartësi prej 421.00 euro.

Me leximin e kërkesës së datës 17.01.2023, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka kërkuar nga e paditura kompensimin e pagave të papaguara.

Me leximin e Ekspertizës financiare e datës 01.03.2024 e ekspertit financiar Ednora Kastrati, gjykata vërtetoi faktin se lartësia e pagave të papaguara për paditësen për periudhën kohore 01.11.2021 deri me 31.10.2022 është paga bruto në vlerë prej 6,147.92€, kontribut pensional i punëdhënësit është në vlerë prej 252.72€, kontributi pensional i punëtorit është në vlerë prej 252.72€, tatim në të ardhura personale është në vlerë prej 225.72€ dhe paga neto është në vlerë prej 4,576.32€.

#### **4. Baza Ligjore**

Sipas nenit 55 paragrafi 1 i Ligjit të Punës parashihet se “*I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit.*” Sipas paragrafi 2 të këtij neni parashihet se “*Të drejtën për pagë, pagën shtesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat e tjera, i punësuari i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me Kontratën e Punës.*” Sipas paragrafi 6 të këtij neni parashihet se “*Paga, paguhet në afatet e përcaktuara me Kontratë Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit ose Kontratën e Punës, më së paku një (1) herë në muaj.*”

#### **5. Vlerësimet përfundimtare të gjykatës**

Gjykata pas administrimit dhe vlerësimit të provave si dhe dispozitave pozitive në fuqi, konstaton se kërkesëpadia e paditësit është plotësisht e bazuar sepse i njëjti ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura si mësimdhënës në periudhën 01.11.2021 deri me 31.10.2022 dhe ka pasur pagën mujore në shumën prej 421.00€ bruto, mirëpo i njëjti për këtë periudhë nuk ka pranuar kompensimin e të ardhurave personale – pagës, të cilën punëdhënësi ka për obligim të i’u kompensoj sipas kontratës së punës nr.344/21 e datës 02.11.2021 dhe nr.169/22 e datës 17.10.2022.

Lidhur me lartësinë e pagave të papaguara, gjykata u bazua në ekspertizën financiare të ekspertit Ednora Kastrati, sipas të cilës lartësia e pagave të papaguara për paditësin për periudhën 01.11.2021 deri me 31.10.2022 është paga bruto 6,147.92€, kontributi pensional i punëdhënësit është në vlerë 252.72€, kontributi pensional i punëtorit është në vlerë prej 252.72€, tatim në të ardhura personale është në vlerë prej 225.72€ dhe paga neto është në vlerë prej 4,576.32€ si dhe lartësia e kamatës në shumë prej 840.44€, kjo ekspertizë nuk pati kundërshtim nga palët ndërgjyqëse dhe të njëjtën gjykata e çmoj si profesionale dhe i’ia falë besimin e plotë.

Lidhur me pretendimet e të paditurës se e njëjta e ka dërguar dokumentacionin e nevojshëm në departamentin përkatës të Ministrisë së Financave në mënyrë që paditësi të përfshihet në listën e pagave, mirëpo ky departament nuk e ka bërë ekzekutimin e pagave me arsyetimin se lidhur me marrëdhënien e punës të krijuar mes të paditurës dhe paditësit nuk është zhvilluar procedura e konkursit publik, gjykata vlerëson se ky pretendim është i pabazuar sepse paditësi kontratën e punës e ka lidhur me të paditurën dhe obligimet nga kjo kontratë i takojnë të paditurës, ndërsa fakti se pagesat bëhen përmes Ministrisë së Financave nuk nënkupton se punëdhënësi në këtë rast është Ministria. Fakti se a është zhvilluar konkurs publik apo jo nuk është objekt i vendosjes në këtë çështje kontestimore dhe lidhur me këtë gjykata nuk lëshohet në çmuarjen të mëtutjeshëm, mirëpo në këtë procedurë gjykata vendosi vetëm brenda kërkesëpadisë së paditësit dhe në bazë të provave të prezantuara pranë gjykatës.

Lidhur me shpenzimet procedurale, gjykata vendosi në bazë të nenit 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe atë shumën në lartësi prej 104€ në emër të hartimit të padisë, 60€ në emër të taksës gjyqësore dhe 270€ në emër të përfaqësimit në dy seanca dhe 100€ në emër të ekspertizës financiare, apo në total shumën prej 534.00€.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**C.nr.342/2023, datë 15.04.2024**

**GJYQTARI**  
**Fuad Haliti**

---

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.